



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.143, datë 18.07.2024

PËR

**“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR
PROKURORIN ELIORA ELEZI”**

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit Nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Eliora Elezi, si eksperte për përgatitjen e një botimi mbi rastet e praktikës gjyqësore që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, të mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE).
2. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Eliora Elezi dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 18.07.2024.

KRYETARI



Mirela Bogdani